



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 1585/Prot.
4

Tiranë, më 24/12/2013

REKOMANDIM

Nr. 55, datë 24/12/2013

Mbështetur në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr 211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe nr 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim-Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit Regjistri i Barrëve Siguruese (R.B.S. sh.p.k) Tiranë.

KONSTATOVA

Në zbatim të Urdhërit nr.234 datë 07.11.2013 u ushtrua kontrolli administrativ pranë kontrolluesit Regjistri i Barrëve Siguruese (R.B.S. sh.p.k) Tiranë. Ky kontroll administrativ u fillua kryesisht nga Komisioneri dhe kontrolluesi u njoftua paraprakisht për ushtrimin e këtij kontrolli.

Kontrolli administrativ kishte për objekt:

- Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale në lidhje me:
 - Qëllimin;
 - Proporcionalitetin;
 - Kohën e ruajtjes të të dhënave personale të mbledhura;
 - Përhapjen e të dhënave personale;
 - Sigurinë e të dhënave personale (neni 27).

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pasi shqyrtoi procesverbalin e kontrollit administrativ, si dhe provat e administruara vëren se:

Kontrolluesi "Regjistri i Barrëve Siguruese" gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij mbledh dhe përpunon të dhëna personale për kategoritë "klientë" dhe "punonjës". Në kategorinë "klientë" përfshihen: Bankat komerciale të nivelit të dytë me të gjithë degët e tyre, shoqëritë e leasing, zyrat noteriale, zyrat e tatim-taksave, si dhe individë të interesuar për kërkimin e informacionit në regjistër për të verifikuar barrë siguruese.

Qëllimi i mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale për kategorinë "klientë" është regjistrimi i Barrëve Siguruese dhe pretendimeve shtetërore kundrejt gjithë llojeve të debitorëve, ndërsa për kategorinë "punonjës" ndërtimi i marrëdhënieve të punës. Kontrolluesi nuk përdorë për qëllime të tjera të dhënat personale të mbledhura për këto kategori. Të dhënat personale për kategorinë "klientë" mblidhen përmes plotësimit të

formularëve të aplikimit, të cilët dorëzohen pranë zyrave të kontrolluesit. Nga punonjësit e kontrolluesit këto të dhëna hidhen në Regjistrin e Barrëve Siguruese. E gjithë procedura që realizohet nga kontrolluesi bazohet në ligjin “Për barrët siguruese”, “Rregullorja e Barrëve Siguruese” si dhe rregullave dhe procedurave të brendshme të hartuara nga kontrolluesi.

Kontrolluesi ka në fuqi “Rregullore e brendshme e RBS”, “Udhëzues i Kryeregjistruesit”, “marrëveshje konfidencialiteti”, “akt marrëveshje” etj. Në këto dokument janë përfshirë rregulla lidhur me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale dhe konfidencialitetit, kërkesa këto të neneve 27, 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.3.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se hartimi i rregulloreve është një pjesë e rëndësishme e masave të sigurisë që në tërësi zbaton kontrolluesi. Hartimi dhe përmirësimi në vazhdimësi i rregullave është një siguri më shumë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të subjekteve të të dhënave gjatë përpunimit të të dhënave personale që kryeni ju si kontrollues.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se për të rritur dhe me tej punën tuaj si kontrollues në drejtim të mbrojtjes të të dhënave personale është shumë e rëndësishme që në faqen tuaj të internetit roel-al.com të publikohen “politikat e privatësisë” (paketë rregullash) me qëllim informimin e personave që vizitojnë faqen tuaj të internetit mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, masat e sigurisë dhe ruajtjes së konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale nisur nga fakti që përdorimi i internetit tashmë është një realitet i prekshëm në Shqipëri, vlerëson si shumë të rëndësishëm publikimin e politikave të privatësisë nga kontrolluesit përmes këtij mjeti shumë të fuqishëm komunikimi dhe informimi. Publikimi i politikave të privatësisë në faqen e internetit nga ana e kontrolluesve të të dhënave personale, është një hap i ri cilësor dhe shumë i rëndësishëm në kuadër të masave që duhet të marrin kontrolluesit në zbatim të kërkesave të nenit 27 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar... “Kontrolluesi ose përpunuesi merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi”.

Sa më sipër:

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, si dhe nenet 107-109 të K. Pr. Administrative ;

REKOMANDOJ

1. Në zbatim të nenit 27 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar:
 - Në faqen tuaj në internet duhet të publikohen “politikat e privatësisë” (paketë rregullash) me qëllim informimin e personave që vizitojnë faqen mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave personale/sensitive, masat e sigurisë dhe ruajtjes së

konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë. Politikat e privatësisë synojnë sensibilizimin e publikut mbi rëndësinë e mbrojtjes së privatësisë dhe të drejtat që gëzojnë në këtë fushë.

2. Kryerja e këtij detyrimi të rëndësishëm të realizohet brenda një afati kohor prej 45 (dyzet e pesë) ditësh, nga momenti i marrjes në dijeni të këtij Rekomandimi.
3. Për plotësimin e këtij detyrimi të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
4. Me kalimin e këtij afati në rast mospërbushje të këtij detyrimi, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, sipas të cilit... "Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave".

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

